

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Bruto Produkti Vendor (BPV) me Qasjen e Shpenzimeve dhe të Prodhimit, 2008-2022

20.09.2023


Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon të dhënat e rishikuara të Bruto Produktit Vendor (BPV) sipas dy qasjeve (sipas aktiviteteve ekonomike dhe me qasjen e shpenzimeve), me çmime aktuale dhe çmime të vitit paraprak për periudhën 2008-2022, bazuar në ESA 2010.

BPV-ja shënon rritje reale për 5,2% krahasuar me një vit më parë

BPV-ja me çmime aktuale në vitin 2022 ishte 8 936.2 milion euro. Derisa, rritja reale në vitin 2022 ishte 5,2%, krahasuar me vitin 2021.

BPV për kokë banori për vitin 2022 ishte 5 037 euro.

Rritja reale e BPV-së vjetore krahasuar me vitit paraprak



Aktivitetet ekonomike me rritje reale

Rritje reale për vitin 2022 kishte në këto aktivitete ekonomike: Tregti me shumicë dhe pakicë; riparim i automjeteve dhe motoçikletave (10,8%); Informim dhe komunikim 9,2%; Aktivitete

profesionale, shkencore dhe teknike (7,0%); Aktivitete administrative dhe mbështetëse (6,7%); Aktivitete financiare dhe të sigurimit (6,4%); Industri përpunuese (5,6%); Transport dhe magazinim (5,4%); Art, zbavitje dhe rekreacion (4,7%); Bujqësi, gjueti, pylltari dhe peshkim (4,5%); Afarizëm me pasuri të patundshme (4,1%); Hotele dhe restorante (3,7%); Shëndetësi dhe aktivitete të punës sociale (3,6%); Edukim (3,2%); Furnizim me ujë (3,0%); Industri nxjerrëse (2,9%); Shërbime të tjera (2,6%); Furnizim me energji elektrike, dhe me gaz (1,4%).

Aktivitetet ekonomike me rënie

Gjatë vitit 2022 kishte rënie në: Ndërtimtari (-3,1%); Administrim publik dhe të mbrojtjes; Sigurim i detyrueshëm social (-0,5%).

Rritja reale sipas komponentëve kryesorë të BPV-së

Rritja reale sipas komponentëve kryesorë të BPV-së me qasjen e shpenzimeve për vitin 2022 ishte: Importi i shërbimeve (21,3%); Eksporti i shërbimeve (20,0%); Eksporti i mallrave (16,1%); Shpenzimet e konsumit final (4,0%); Importi i mallrave (FOB) (2,2%); Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë (0,2%).

Komponentët kryesorë të BPV-së me rënie

Rënie kishte te këta komponentë: Ndryshimet në inventar (-10,6%); dhe Formimi i kapitalit bruto (-3,8%).

Bruto Produkti Vendor 2008-2022 (Mijëra EUR)

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
BPV-ja Nominale	3 610 441	4 030 991	4 555 903	4 797 278	5 071 333	5 325 095	5 674 422	6 037 273	6 356 456	6 671 522	7 056 172	6 771 601	7 957 876	8 936 177
BPV-ja Reale	3 715 713	3 788 794	4 285 742	4 633 909	5 053 492	5 241 163	5 640 140	5 990 588	6 328 610	6 572 997	6 988 873	6 679 352	7 499 253	8 373 165
Rritja reale e BPV-se %	5,0	4,9	6,3	1,7	5,3	3,3	5,9	5,6	4,8	3,4	4,8	- 5,3	10,7	5,2

(në 000)

Për më shumë informata lidhur me Bruto Produktin Vendor (BPV) me qasjen e shpenzimeve dhe të prodhimit për vitin 2008-2022, vizitoni: <https://ask.rks-gov.net/Themes/Budget>